



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K



Nr. 427 / 5 Regj

Pogradec më 03.06.2022

URDHËR

"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr 33,

Tiranë.

**Drejtuar Debitorit: Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, me administrator Z.Ervin Braho,
me NUIS-K33708651V.**

Adresa: Dampa Provizore, ish-stacioni i Trenit, Mëmëlisht,

Pogradec.

Për djeni Kreditorit: Shoqëria MIT OIL-TRANS DOOEL , me administrator Znj. Marina Stanojkoviq, me NUIS-4024009501607, përfaqësuar me "Prokurë" të Shoqërisë datë 01.07.2020, dhe "Prokurë e Posaçme" me Nr.1736 Rep, Nr.880 Kol, datë 02.07.2020, nga Z. Mitre Sterjofski dhe Av.Budion Hoxha.

**Adresa:1-Rruga "Boris Kidriç", Nr.178, Resnjë,
2-Rruga "Naim Frashëri", Lagjia Nr.3,**

Maqedonia e Veriut.
Pogradec.

Në Regjistrin e Titujve Ekzekutivë të Shoqërisë Zyrë e Përmbarrimit Privat "QEVA" sh.p.k, Pogradec, me kërkesë të palës kreditore më datën 06.05.2022, është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 427 regjistri me palë :

Kreditor : Shoqëria MIT OIL-TRANS DOOEL.

Debitor : Shoqëria "FADA 1" sh.p.k.

Objekti: Pagimin shume.

Unë përmbarruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbarrimore :

KONSTATOVA :

Kreditori **Shoqëria MIT OIL-TRANS DOOEL**, ka paraqitur për ekzekutim ekzekutiv, vendimi me Nr. (268)-89, të datës 12.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku është vendosur detyrimi i debitorit Shoqëria "FADA 1" sh.p.k në favor të kreditorit Shoqëria MIT OIL-TRANS DOOEL, ku është vendosur:

-Detyrimi i debitorit Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, të paguajë shumën prej 15.337 (Pesëmbëdhjet mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) Euro, detyrim që rrjedh nga kontrata e transportit të mineralit datë 03.08.2018.

-Detyrimi i debitorit Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, të paguajë si kamatvonesë ligjore kreditorit në shumën 7.079.⁷¹ (Shtatë mijë e shtatëdhjet e nëntë pik shtatëdhjet e një cent) Euro, për përlllogaritjen deri më datën 22.04.2021.

-Detyrimi i debitorit Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, të paguajë si interesa ditore kreditorit në shumën 6.²⁹ (Gjashtë euro pik njëzet e nëntë cent) Euro, duke filluar përlllogaritjen nga data 22.04.2021 deri në ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv, 23.04.2021-03.06.2022, nga e cila janë 406 ditë x 6.²⁹ = 2.553.⁷⁶ Euro.

-Detyrimi i debitorit Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, të paguajë shpenzimet gjyqësore në shumën 98.981 (Nëntëdhjet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjet e një) lekë.

Totali e detyrimit të debitorit deri në këtë moment pa tarifën e shërbimit përmbarimor, është në shumën 24.970.⁴⁵ Euro dhe shpenzimet gjyqësore në shumën 98.981, sipas kursit zyrtar të këmbimit valuator më datën e regjistrimi është 1 Euro = 119.⁹⁷ lekë e çmimit në blerje dhe 1 Euro = 120.⁶¹ lekë në shitje (24.970.⁴⁵ euro x 120.⁶¹ lekë = 3.011.686 lekë + 98.981 lekë = 3.110.667 lekë).

-Debitori është i detyruar të paguajë tarifën fikse të shërbimit përmbarimor sipas udhëzimit nr. 385/7 datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat" në vlerën në vlerën 298.624 (Dyqind e nëntëdhjet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) Lekë (2.489 Euro).

Në total, debitori është i detyruar të paguajë detyrimin në shumën 24.970.⁴⁵ (Njëzet e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjet pik dyzet e pesë) Euro dhe shumën 397.605 (Treqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë, deri në këtë moment pasi do i përlllogariten kamatvonesat ligjore ditore.

Në datën 23.05.2022, ora 12.42, në emailin zyrtar të debitorit Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, njoftimi për ekzekutimin e titullit në mënyrë vullnetare. Afati i ekzekutimit në mënyrë vullnetare ka kaluar dhe pala debitore nuk ka respektuar afatin ligjor për ekzekutim vullnetar. Në këto kushte ekzekutimi i titullit do të vazhdojë në ekzekutim të detyrueshëm për vjeljen e detyrimit, ku do të vendoset sekuestro konservative në llogaritë e palës debitore, si dhe do të parashikohen saksione ndaj personit përgjegjës të ngarkuar nga ligji për pengim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Për këtë arsye : Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile

URDHËROJMË

1 - Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi kuotat/aksionet, e palës debitore Shoqëria "FADA 1" sh.p.k, me NIPT- K33708651V, me Adm Z.Ervin Braho, për shlyerjen e detyrimit në shumën 24.970.⁴⁵ (Njëzet e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjet pik dyzet e pesë) Euro dhe shumën 397.605 (Treqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë, përfshirë këtu detyrimi, interesat shpenzimet gjyqësore e përmbarimore dhe tarfën e shërbimit përmbarimor.

2-Mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar. Dokumentacioni do të qendrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.

3- Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

5- Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dieni.

ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K PËRMBARUESI GJYQËSOR

Erzen QEVA

